



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITSHËM VLORË**

Nr. 3708 Prot.

Vlorë më, 24.02.2026

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR PUNONJËSE SIGURIE

Në zbatim të ligjit Nr 97 dt.06.10.2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 42,71,e në vijim), Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kërkon të punësojë një punonjëse femër në administratë me detyrë punonjëse sigurie.

Përshkrimi i punës:

Kushtet e përgjithshme:

- a) Të jetë shtetase shqiptare, me moshë deri në 50 vjeçe.
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, si dhe të mos jetë nën hetim;
- dh) Ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga detyra që nuk është shuar sipas afateve të parashikuara në ligj;
- e) Të ketë pëfunduar arsimin e mesëm;

Përshkrimi i punës:

Punonjësja e sigurisë duhet të kryej detyrën me përgjegjshmëri dhe korektesë të lartë, me qëllim ruajtjen e rendit, të sigurisë së godinës dhe personelit të Prokurorisë duke përmbushur të gjitha kërkesat si më poshtë:

- a) Të zbatojë me përpikmëri sigurimin e rregullit të brendëshëm dhe ruajtjen e rendit në ambjentet e Prokurorisë.
- b) Të kërkojë nga gjithë personeli zbatimin e rregullit të brendëshëm dhe ruajtjen e rendit në ambjentet e Prokurorisë.
- c) Të lejojë hyrjen për nevoja pune e shërbimi, apo takime me punonjësit e institucionit personave të jashtëm, vetëm pas njoftimit të punonjësit dhe shoqërimin e tyre te punonjësi nga i cili është thirrur.
- d) Të kërkojë nga personat e jashtëm kalimin në aparaturën e kontrollit.
- e) Të regjistrojë në regjistrin përkatës emrin e personit të jashtëm që do të lejohet në Prokurori, duke shënuar orën e hyrjes, /daljes dhe të punonjësit që e ka thirrur.

- f) Të mbajë sendet personale, si dhe armën (në rast se kanë) duke bërë regjistrimin përkatës të numrit të saj në regjistër dhe kthimin e tyre pas përfundimit të takimit.
- g) Të komunikojë me sektorët përkatës për ankesat që kanë qytetarët duke i sqaruar ata vetëm sipas përgjigjes së marrë nga zyrat përkatëse, pa dhënë mendime e shpjegime personale.
- h) Tu kërkojë personave që paraqiten për takim dokument identifikimi, ti paisi me fletëhyrje, dhe në përfundim të takimit tu kthejë dokumentin e identifikimit.
- i) Të zbatojë me përpikmëri dhe korrektes orarin e shërbimit.
- j) Të bashkëpunojë me punonjësit e ruajtjes së objektit për zbatimin me korektësi të kërkesave të rregullores së brendëshme dhe të kërkesave specifike të sigurimit fizik të objekteve shtetërore.
- k) Të mos lëri vetëm për asnjë moment vendin e shërbimit.
- l) Të jetë e kujdesshme me qytetarët, dhe në rast konflikti të njoftojë eprorër, dhe kur gjykon se cenohet rendi dhe sigura e institucionit të kërkojë ndihmën e punonjësit të policisë së shtetit.
- m) Të zbatojë detyrat specifike të dhëna nga eprorët për situata të ndryshme si festa, pushime apo situata gadishmërie.
- n) Në rast fatkeqësish natyrore si zjarr, përmytje, difektë i rëndë elektrik etj njoton zjarrfikësit dhe eprorët përkatës, si dhe vepron me iniciativë me fikset apo hidrantët e ujit, duke eliminuar përhapjen e rrezikut.
- o) Të zbatojë edhe detyra të tjera të dhëna nga eprorët.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së mesme.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje të librezës së punës.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deri në datën 12.03.2026 ora 08:00-16:00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kancelari i Prokurorisë, e cili pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nga Komisioni i Pranimi bazuar në dokumentacionin e

secilit kandidat si dhe rezultatit të intervistës me secilin prej tyre. Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambientet e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në datën që do të vendoset nga komisioni i pranimi për kandidatët e kualifikuar me telefon ose e-mail nga Kryesekretaria.

Për çdo sqarim mund të paraqiteni në ambjentet e kësaj Prokurorie çdo ditë nga dita e hënë deri ditën e premte nga ora 08.00 - 16.00, (ku do të gjeni edhe njoftimin e afishuar në hyrje të Prokurorisë), ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al/Vlorë, ku do të publikohet kjo shpallje.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

